

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
DIREKTORA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIONE

74  
21.05.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



STATUTIN

E

QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE "DR. FATMIR KRASNIQI"

FUSHË-KOSOVË

Maj 2024

Bazuar në nenin 8, paragrafi 2, nenin 18 paragrafi 12, nenin 45 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2013), nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 17, shkronja (m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (i), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2024, të vazhduar me datën 13.05.2024 dhe 16.05.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 427, të datës 22.02.2024, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, miraton:

## **STATUTIN**

### **E**

## **QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE “DR. FATMIR KRASNIQI”**

### **FUSHË KOSOVË**

#### **Neni 1**

#### **I - Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë Statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësirni dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF-së, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Fatmir Krasniqi”, në tekstin e mëtejme: QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi”.

#### **Neni 2**

#### **Statusi i QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi”**

1. QKMF-ja ka statusin e personit juridik publik, me cilësi të autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet Kujdesi Parësor Shëndetësor Publik, në tekstin e mëtejme: KPSH.
2. Themelues i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” është Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës.
3. QKMF-ja “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë-Kosovë ka filluar punën në vitin 1983, fillimisht si “Shtëpi e Shëndetit”.

## **II - Emërtimi dhe selia**

### **Neni 3**

#### **Emërtimi**

1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr.Fatmir Krasniqi” në Fushë-Kosovë.
2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF në Republikën e Kosovës dhe aprovet nga Kuvendi i Komunës, në bazë të procedurave ligjore.
3. Emërtimi i QKMF, QMF dhe AMF duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të institucionit shëndetësor përkatës të KPSH.
4. Për ndryshimin e selisë së QKMF “Dr Fatmir Krasniqi” vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë-Kosovë, gjendet në rrugën “Bedri Pejani”.

### **Neni 5**

#### **Vula**

1. QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dr.Fatmir Krasniqi”.
2. Vula është në formë të rumbullaket dhe ka dimension 3.5 m, 35 mm.
  - 2.1 Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
  - 2.2 Rrethi i dytë: Komuna e Fushë Kosovës;
  - 2.3 Rrethi i tretë: QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë-Kosovë;
  - 2.4 Në mes të vulës është logoja unike për të gjitha QKMF-të në Republikën e Kosovës.
3. QKMF-ja “Dr. Fatmir Krasniqi” posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm, që përmban emërtimin, selinë dhe hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit.
4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit, sipas këtij Statuti dhe të jetë në gjuhët të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë.
5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje vendos drejtori.
6. Çdo vulë ka numër identifikues.

## **III - Veprimtaria, Shërbimet dhe Përfaqësimi i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”**

### **Neni 6**

#### **Veprimtaria**

1. Veprimtaria e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” përfshinë ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.
2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Fushë-Kosovës

t'iu ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse, efikase dhe në vazhdimësi individit dhe familjes në të gjitha fazat e jetës, bazuar në të dhëna shkencore, përmes mjekut familjar si mjek i përzgjedhur i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese për specialistët konsultantët në KPSH dhe në nivelet tjera të kujdesit shëndetësor.

3. Sipas SSSH 2017-2021 dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një mjekë familjar dhe dy infermiere familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.
4. Standardet në mjekësinë familjare sipas këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodikë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.
5. Shërbimet shëndetësore në QKMF-në "Dr. Fatmir Krasniqi" në Fushë-Kosovë sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësor të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin për Shëndetësi:
  - 5.1 Specialist i Mjekësisë Familjare;
  - 5.2 Doktor i Mjekësisë;
  - 5.3 Doktor i Stomatologjisë;
  - 5.4 Specialist i pedodoncisë dhe preventivës;
  - 5.5 Farmacist i diplomuar - magjistër i farmacisë;
  - 5.6 Specialist i Biokimisë klinike;
  - 5.7 Infermier i/e diplomuar;
  - 5.8 Mami e diplomuar;
  - 5.9 Teknik laborant;
  - 5.10 Teknik i farmacisë;
  - 5.11 Teknik/asistent i stomatologjisë;
  - 5.12 Radiologu dhe tekniku i radiologjisë në institucionet ku funksionon kabineti i Rtg;
  - 5.13 Profesionistët shëndetësorë të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të Ministrisë;
  - 5.14 Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmisë së mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, në bazë të propozimit të Odës përkatëse të profesionistëve sipas Ligjit të Shëndetësisë.
6. Në QKMF ku funksionojnë maternitetet, është i domosdoshëm Gjinekologu dhe Neonatologu ose Pediatri.
7. Specialistët nga lëmitë e tjera, mund të vazhdojnë punën në KPSH si konsulent të Mjekëve Familjarë deri në pensionim.
8. Konsulentët në KPSH sipas paragrafit 7 të këtij neni ofrojnë shërbime konsultative në QKMF dhe QMF.
9. Mjeku familjar duhet të jetë i çertifikuar për të ofruar shërbime me Ultrazë.

## **Neni 7** **Shërbimet**

1. QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:
  - 1.1 Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin;

- 1.2 Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese;
- 1.3 Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike;
- 1.4 Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent;
- 1.5 Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sërnundjet kronike;
- 1.6 Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjë;
- 1.7 Shërbimet e shëndetit riprodhues;
- 1.8 Shërbimet e shëndetit oral parandalues;
- 1.9 Shërbimet e shëndetit mendor;
- 1.10 Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit ndaj nënës dhe fëmijes, kujdesi paliativ si dhe kujdesi shtëpiak bazuar në nevojat e popullatës dhe prioritetet e shëndetit publik;
- 1.11 Shpërndarjen e barërave nga lista esenciale.

## **Neni 8**

### **Përfaqësimi**

1. QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë-Kosovë është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor publik në Republikën e Kosovës.
2. QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi.
3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi.
4. Drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” me pëlqim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

## **IV. Struktura e Institucionit në QKMF**

### **Neni 9**

### **Orgnizimi i QKMF-së**

1. QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi” me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:
  - 1.1 Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:
    - 1.1.1 Sektori i Mjekësisë Familjare;
    - 1.1.2 Njësia e SISH;
    - 1.1.3 Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit;
    - 1.1.4 Sektori i Shëndetit Oral Preventiv;
    - 1.1.5 Sektori i Kujdesit Urgjent;
    - 1.1.6 Sektori konsultativë dhe diagnostikë.
      - 1.1.6.1 Shërbimet Konsultative;
      - 1.1.6.2 Kabineti Radiologjik;
      - 1.1.6.3 Laboratori.

1.2 Departamenti i Administratës së QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë Kosovë organizohet në:

- 1.2.1 Njësia ose Zyra e personelit,
- 1.2.2 Njësia ose Zyra Juridike,
- 1.2.3 Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa,
- 1.2.4 Njësia ose zyra e prokurimit
- 1.2.5 Njesia ose Zyra për shërbime teknike

1.3 Departamenti i Barnatores qëndrore

1.3.1 Barnatorja qëndrore është njësi organizative e QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike;

1.3.2. Në QMF / AMF funksionojnë barnatoret doracake të cilat menaxhohen, furnizohen dhe monitorohen nga barnatorja Qëndrore në QKMF;

1.3.3.Nga barnatorja qëndrore dhe njesitë e saja në QMF/AMF shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria dhe të përshkruara në recetat unike , nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare;

1.3.4 Me barnatoren qëndrore udhëheq Shefi i Barnatores.

2. QMF Fushë Kosovë I , QMF Bardh I Madh , QMF Sllatinë e Madhe ,QMF Miradi e Poshtme, QMFMiradi e Epërme, AMF Vragoli, AMF Graboc i Poshtëm, AMF Bardh i Vogël, AMF Hencë, AMF Kuzmin, në kuadër të QKMF "Dr.Fatmir Krasniqi" në Fushë Kosovë përbën Rrjetin e institucioneve të KPSH në Komunën e Fushë Kosovës.

3.Rrjeti i institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 2 do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës me pëlqim të Ministrisë së Shëndetësisë.

## **Neni 10**

### **Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi"**

1.QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" ne Fushë Kosovë zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu si që është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

2.Departamenti i SISH në Ministrinë e Shëndetësisë në koordinim me QKMF bënë implementimin e Sistemit dhe funksionalizimin e tij në të gjitha nivelet e institucioneve të KPSH-së.

3.QKMF obligohet të përdor sistemin Informativ Shendetesor nga MSh për të gjitha llojet e shërbimeve te ofruara duke perfshirë edhe bashkëpagesat.

4.Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale çdo profesionist shëndetësor obligohet që të ruaj konfidencialitetin e të dhënave për të gjitha veprimet e ndërmarra me Sistemin e Informimit Shëndetësor.

## V. Udhëheqja dhe trupat e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”

### Neni 11

#### Këshilli Drejtues - Struktura

1. Këshilli Drejtues ka shtatë 7 anëtarë:
  - 1.1 Drejtori i QKMF, i cili e kryeson Këshillin;
  - 1.2 Udhëheqësi i Departamentit të Mjekësisë Familjare;
  - 1.3 Kryeinfermieri/ja i/e QKMF-së;
  - 1.4 Udhëheqësi i Departamentit të Administratës;
  - 1.5 Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
  - 1.6 Përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit;
  - 1.7 Përfaqësues nga Këshilli i pacientëve.
2. Mandati i anëtareve të Këshillit Drejtues zgjatë sa edhe kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur:
  - 2.1 Anëtari ndërpre në marrëdhënien e punës në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi”;
  - 2.2 Anëtari i Këshillit Drejtues jep dorëheqje;
  - 2.3 Anëtari i Këshillit Drejtues mungon pa arsye në mbledhje të Këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi;
  - 2.4 Anëtari nuk respekton detyrat e punës.

### Neni 12

#### Kompetencat dhe Detyrat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues kryen detyrat të përcaktuara me këtë Statut dhe vendos për:
  - 1.1 Veprimtarinë e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe vërteton politikën punuese të QKMF së “Dr. Fatmir Krasniqi”;
  - 1.2 Propozon ndryshimet e Statutit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të cilat propozime pas dhënjes së pëlqimit nga ana e Minsitrit të Shëndetësisë, i aprovon Kuvendi Komunal;
  - 1.3 Aprovon raportin e punës dhe llogaritë vjetore të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe raportin në Divizionin e Kujdesit Parësor në Ministrinë e Shëndetësisë, përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
  - 1.4 Vendos për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;
  - 1.5 Përgatitë programin e punës dhe planin financiar;
  - 1.6 Harton rregulloren për organizimin e punës në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe aktet tjera në përputhshmëri me ligjin dhe me këtë Statut;
  - 1.7 Harton planin e burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit Profesional brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikën e Ministrisë së Shëndetësisë;
  - 1.8 Miraton planin vjetor për Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional të kuadrit mjekësor dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij;
  - 1.9 Bën planin dhe programin e masave për mbrojtje në punë;
  - 1.10 Emëron komisione të përkohshme dhe organe tjera punuese;
  - 1.11 Vendos për sigurimin e pasurisë së QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;

- 1.12 Propozon ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve duke u bazuar në politikën shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë;
- 1.13 Shqyrton njoftimet mbi mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme mbi punën profesionale, kryen edhe punë të tjera të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”.
2. Këshilli Drejtues i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” i kryen detyrat brenda përgjegjësisë së veta në takime;
3. Këshilli Drejtues mban takime të rregullta në të cilat marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve;
4. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicë të votave të anëtarëve të zgjedhur;
5. Në takimet e Këshillit Drejtues mbahet procesverbali, të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në takimin vijues.
6. Këshilli i pacientëve:
  - 6.1 Përfaqëson interesat e pacientëve në Institucionet e KPSH-së;
  - 6.2 Organizon pacientët për të mbështetur institucionin në ofrimin e kujdesit shëndetësor;
  - 6.3 Krijon mekanizmat e komunikimit midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe pacienëve.

### **Neni 13**

#### **Drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”**

1. QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi” e udhëheq Drejtori i QKMF-së.
2. Drejtori përfaqëson, prezanton QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës.
3. Drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi”, Drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
4. QKMF që kanë një personel mbi 100 të punësuar kanë Zëvendës Drejtorin.
5. Zëvendës drejtori ndihmon në ushtrimin e detyrave të përditshme dhe vepron në emër të drejtorit në mungesë të tij.

### **Neni 14**

#### **Procedura për emërimin e Drejtorit**

1. Drejtorin e zgjedhë Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
2. Drejtor i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi:
  - 2.1 Të jetë mjek specialist nga Mjekësia Familjare;
  - 2.2 Përparësi do të kenë kandidatët të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor;
  - 2.3 Kandidati për Drejtor duhet t'i ketë 5 vite përvojë pune në sistemin shëndetësor publik prej tyre 3 vite përvojë pune në pozita menaxheriale.
3. Vendimin për publikimin e konkursit për Drejtor të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” e merr



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

4. Procedurat për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit e udhëheqë Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

#### **Neni 15**

#### **Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”**

1. Drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, si dhe për punën profesionale të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe akteve tjera normative.
2. Drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” është përgjegjës për përkujdesjen efikase dhe efektive të shëndetësisë parësore publike, për të gjithë banorët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë:
  - 2.1 Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125 dhe SSSH, UA për KPSH, Drejtori i QKMF i propozon për miratim, Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
  - 2.2 Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore;
  - 2.3 Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, zbaton buxhetin e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”;
  - 2.4 Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi”;
  - 2.5 Avancoon punën ekipore;
  - 2.6 Mundëson Zhvillimin e Vazhdueshem Profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”;
  - 2.7 Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë;
  - 2.8 Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”.
3. Programi i punës së QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi” si:
  - 4.1 Plani vjetor i punës;
  - 4.2 Organizimi dhe udhëheqja;
  - 4.3 Burimet njerëzore;
  - 4.4 Plani financiar;
  - 4.5 Raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare;
5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, i përgjigjet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

#### **Neni 16**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë tjera të Drejtorit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”**

1. Drejtori ka për detyrë që, gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli Drejtues, të

tërheqë vëmendjen:

- 1.1 Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht, në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
- 1.2 Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin e punës së QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
- 1.3 Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

#### **Neni 17**

#### **Trupat e QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi"**

1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli Drejtues, përmes drejtorit të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", formon Trupa Profesionale në QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi", si që janë:
  - 1.1 Këshilli Profesional;
  - 1.2 Komisioni Disiplinor i QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
  - 1.3 Komisioni i Ankesave i QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
  - 1.4 Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore;
  - 1.5 Komisioni Etiko - Profesional.
2. Anëtarët e trupave profesionale emërohen nga Drejtori i QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi";
3. Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF-në "Dr. Fatmir Krasniqi".

#### **Neni 18**

#### **Këshilli Profesional**

1. Këshilli Profesional është trup këshillëdhënes i Drejtorit të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
2. Këshilli Profesional përbëhet nga udhëheqësit e departamenteve, udhëheqësit e sektorëve dhe njësisë, shefit të barnatorës si dhe kryeinfermieri/ja e QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", sipas nenit 9 të këtij statuti;
3. Kryetar i Këshillit Profesional, sipas detyrës zyrtare, është Udhëheqesi i Departamentit të Mjekësisë Familjare të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi";
4. Këshilli Profesional harton Rregulloren e punës për punën e Këshillit.
5. Kryetari i Këshillit Profesional i kryen këto punë:
  - 5.1 Përgatit, thërret dhe udhëheq takimet e Këshillit Profesional;
  - 5.2 Verifikon rendin e ditës së takimeve dhe
  - 5.3 Siguron mbajtjen e procesverbalit të takimeve.
6. Kryetari i Këshillit Profesional është i obliguar ta thërras mbledhjen brenda 3 tri ditëve, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi".
7. Këshilli Profesional i QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:
  - 7.1 Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;
  - 7.2 Propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit marrjen e masave profesionale për përmirësimin e

- organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
- 7.3 Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
  - 7.4 Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësor në përsosje profesionale;
  - 7.5 Kërkon raport me shkrim nga profesionistët shëndetësor për njohuritë e fituara nga Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional;
  - 7.6 Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit Profesional.

#### **Neni 19**

#### **Komiteti për Cilësi dhe Siguri të Shërbimeve Shëndetësore**

1. Në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi” funksionon Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;
2. Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore në vazhdim vetëm Komiteti, është një ekip multi-disiplinar i cili përbëhet nga:
  - 2.1 Drejtori i institucionit;
  - 2.2 Drejtori i infermierisë, Kryeinfermieri në QKMF;
  - 2.3 Koordinatori për sigurimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;
  - 2.4 Drejtori shëndetësor, Kryeshefi i Departamentit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve;
  - 2.5 Drejtori operativ-administratës, Kryeshefi i administratës në KPSH.
3. Varësisht nga institucioni shëndetësor, ky komitet mund të ketë edhe anëtarë të tjerë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e komitetit janë të bazuara në dispozitat e statutit të institucionit shëndetësor.

#### **Neni 20**

#### **Komisioni Etik-Profesional**

Komisioni Etik - Profesional është trup i cili denoncon, rastet e shkeljeve sipas ligjit për odat e profesionistëve shëndetësor.

#### **Neni 21**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë**

Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli Drejtues, përmes Drejtorit të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga Ministria e Shëndetësisë.

#### **Neni 22**

#### **Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional**

1. Institucionet shëndetësore në KPSH janë të obliguara, që të mundësojnë dhe përkrahin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësorë.

2. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në KPSH, dhe zbatohet sipas planprogramit, të aprovuar nga Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.
3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga paragrafi 2, i këtij neni përgjegjës janë Koordinatorët dhe trajnuesit në Programet e Mjekësisë Familjare dhe të Infermierisë Familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike e profesionale dhe caktohen sipas termave të referencës të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.
4. Financimi i Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të profesionistët shëndetësor, bëhet nga buxheti i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” dhe burime të tjera bazuar në aktet normative në fuqi.

## **VI. Mbikëqyrja e QKMF “Dr. Fatmir Krasniqi”**

### **Neni 23**

#### **Llojet e mbikëqyrjes në QKMF-në “Fatmir Krasniqi”**

1. QKMF i nënshtrohet mbikëqyrjes së brendshme dhe të jashtme në pajtim me dispozitat në fuqi, që sigurohet përmes Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyren e paraparë me Rregulloren për mbikëqyrje të brendshme, të cilën e propozon Këshilli Drejtues i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”;
3. Mbikëqyrja e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” përfshinë:
  - 3.1 Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve;
  - 3.2 Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të percaktuara nga Ministria;
  - 3.3 Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve në përputhje me rregullat e Prokurimit Publik.

## **VII. Aktet nga veprimtaria e Institucionit**

### **Neni 24**

#### **Aktet e përgjithshme**

1. Me propozim të Drejtorit, Këshilli Drejtues i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” nxjerr këto akte të përgjithshme:
  - 1.1 Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
  - 1.2 Rregulloren për punë;
  - 1.3 Rregulloren për mbrojtjen në punë;
  - 1.4 Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
  - 1.5 Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
  - 1.6 Rregulloren për rendin shtëpiak;
  - 1.7 Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;

1.8 Rregulloren për parandalimin e infeksioneve dhe

1.9 Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi”.

## **VIII. Pronësia Buxheti dhe Financat**

### **Neni 25**

#### **Pronësia**

1. QKMF-ja “Dr. Fatmir Krasniqi” ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Kuvendit të Komunës.
2. QKMF-ja “Dr. Fatmir Krasniqi”, si institucion i KPSH është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Kosovës.
3. Pasurinë e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, me të cilat QKMF-ja “Dr. Fatmir Krasniqi”, ka të drejtë të disponojë në pajtim me aktet ligjore në fuqi.

### **Neni 26**

#### **Buxheti**

1. Ç ështëj buxhetore dhe financiare të QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me legjislacionin në fuqi për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.
2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, përfshijnë tërë shpenzimet operative të njësive punuese.
3. Prokurimi i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi”, bëhet në pajtim me rregullat e Prokurimit Publik sipas Ligjit në fuqi dhe akteve nën-ligjore.
4. Drejtori mund të kërkojë auditim të jashtëm dhe të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të Mjeteve financiare.

### **Neni 27**

#### **Financimi**

1. QKMF-ja “Dr Fatmir Krasniqi”, shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nga Buxheti i Kosovës, Komunave dhe nga burimet e tjera të parapara me ligjet përkatëse.
2. Procedura dhe forma e bashkëpagesës për shërbimet e ofruara në QKMF-në “Dr. Fatmir Krasniqi”, përcaktohen me akt nënligjore bazuar në Ligjin për Shëndetësi.

### **Neni 28**

#### **Shtojca**

Aneksi është pjesë përbërëse e këtij Statuti.

## IX. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

### Neni 29

#### Periudha kalimtare dhe shfuqizimi

1. Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë të këtij Statuti, mbeten aktet që janë në fuqi dhe që nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti shfuqizohet, Statuti i QKMF-së “Dr. Fatmir Krasniqi” Fushë-Kosovë me Nr. 40, i datës 29.09.2017.

### Neni 30

#### Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Kuvendi i Komunës Fushë-Kosovë**

Nr. 74

Datë: 21.05 2024

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Ali Ismaili**

